



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

05 Nr. ____ / 2011

Data : ____ / 2011

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës , 01 Nr.16/5692 si dhe vendimit 01. Nr. 16/5690 të datës 27.04.2011, Drejtoria e Arsimit në Gjilan shpall :

K O N K U R S PËR NDARJEN E BURSAVE DHE SHPËRBLIMEVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË GJILANIT

I. Sipas këtij konkursi ndahen 50 bursa për studentë të dalluar të Komunës së Gjilanit, për vitin akademik 2010/2011 :

- a) 30 bursa në vlerë prej 60 € për studentët e Komunës së Gjilanit që studiojnë në Universitetet e Kosovës jashtë Komunës së Gjilanit
- b) 20 bursa në vlerë prej 40 € për studentët e Komunës së Gjilanit që studiojnë në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit.

c)

Kriteret e përgjithshme për të fituar bursën :

- Studentët që studiojnë në universitetet publike.....2 pikë,
- Studentët që studiojnë në universitetet private.....1 pikë,
- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Gjilanit,
- Shfrytëzues të bursës studentore mund të jenë vetëm studentët rregullt,
- Nuk do të ketë më shumë se dy bursa për profile të njëjta,
- Studentët që janë shfrytëzues të bursës universitare apo ndonjë burse tjetër nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të kësaj burse,
- Studentët që janë në marrëdhënie të përhershme pune nuk mund të jenë përfitues të bursës

Kriteret e veçanta për të fituar bursën :

- Nota mesatare 10 poentohet me 10 pikë, nëse nuk e ka mbërri bursën e universitetit, të sillet vërtetimi,
 - Nota mesatare 9 poentohet me 9 pikë,
 - Nota mesatare 8 poentohet me 8 pikë,
 - Nota mesatare 7 poentohet me 7 pikë.
- Studentët të cilët janë fëmijë, motër apo vëlla të dëshmorit, studentët që kanë qenë pjesëmarrës të UÇK-së, rastet sociale (të sillet vërtetimi nga enti për punësim, që nuk kanë të punësuar) do të poentohen me 1 pikë .

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Certifikata e notave (originale),
- Kopja e indeksit me të gjitha provimet e dhëna,
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë, vëlla, motër e dëshmorit,
- Certifikata mbi gjendjen ekonomike në emër të prindit,
- Vendimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2010/2011,
- Vërtetimi e studenti/ja ka qenë pjesëtar i UÇK-së,
- Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2010/2011 (i rregullt).

Vërejtje : bursat do të ndahen vetëm për studentë që kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve.

Bursat ndahen për afatin kohor : 01.09.2010 deri më 30.06.2011 (për dhjetë muaj).

II. Po ashtu, sipas këtij konkursi ndahen 20 shpërblime për studentë të dalluar të Komunës së Gjilanit, në vlerë prej 200€ në bazë të kriterëve si vijon :

- a. Përfshirja e të gjitha profileve, nga secili profil nga një student,
- b. Përfitues do të jenë ata studentë me mesataren më të lartë në konkurrencë brenda një profili,
- c. Te studentët e një profili me kushte të barabarta do të merret për bazë mesatarja më e lartë e notave profesionale.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Drejtori

Bujar Nevzati